



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**

BORDI

VENDIM

Nr. 17, Datë 26.02.2016

PËR

**MIRATIMIN E DISA SHITESAVE DHE NDRYSHIMEVE NË RREGULLOREN NR. 34,
DATË 28.05.2015 “PËR RAPORTIMIN E DETYRUAR DHE PERIODIK TË
SHOQËRIVE TË SIGURIMIT DHE RISIGURIMIT”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 2, të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, të nenit 85, pika 3 dhe nenit 111, pika 1, të ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, me propozim të Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I :

- 1. Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në rregulloren “Për raportimin e detyruar dhe periodik të shoqërive të sigurimit dhe risigurimit”, miratuar me vendim Bordi nr. 34, datë 28.05.2015, sipas materialit bashkëlidhur.**
- 2. Ngarkohet Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Enkeleda SHEHI

Neni 1

Në aneksin 1, “Forma, përmbajtja dhe mënyra e plotësimit të pasqyrave financiare 3 mujore”, të nenit 4, pika 1, shkronja “a”:

I. Pasqyra FI 10Q “Llogari të arkëtueshme tregtare”, ndryshon si vijon:

Llogari të arkëtueshme tregtare	FI 10Q
I.	Llogari të arkëtueshme tregtare që rrjedhin nga veprimtaria direkte e sigurimit
1.	Policëmbajtës
	<= 90 ditë
	90 ditë deri 1 vit
	> 1 vit
2.	Ndërmjetës
	<= 90 ditë
	90 ditë deri 1 vit
	> 1 vit
3.	Filiale dhe shoqëri të bashkëkontrolluara
	<= 90 ditë
	90 ditë deri 1 vit
	> 1 vit
4.	Llogari të tjera të arkëtueshme tregtare që rrjedhin nga veprimtaria direkte e sigurimit
	<= 90 ditë
	90 ditë deri 1 vit
	> 1 vit
II.	Llogari të arkëtueshme tregtare që rrjedhin nga veprimtaria e risigurimit
1.	Llogari të arkëtueshme tregtare nga risigurimi
	<= 90 ditë
	90 ditë deri 1 vit
	> 1 vit
2.	Llogari të arkëtueshme tregtare nga risiguruesi
	2.1 >=BBB- (nga S&P, ose të barasvlefshme nga agjencitë e tjera)
	<= 90 ditë
	> 90 ditë
	2.2 < BBB- (nga S&P, ose të barasvlefshme nga agjencitë e tjera)
	<= 90 ditë
	> 90 ditë

II. Në pasqyrën FI 15Q “Shpenzimet administrative”:

1. Në grupin 3 “Tatime e taksa të tjera të ngjashme”:
 - a) Emërtimi i zërit 3.2 “Taksa shërbimi”, ndryshohet në **“Taksa vendore”**.
 - b) Emërtimi i zërit 3.5 “Taksa dhe gjoha të tjera” ndryshohet në **“Gjoha të tjera”**.
2. Në grupin 5 “Shpenzime të tjera administrative”, pas zërit 5.8 “Mbështetje dhe sponsorizime”, shtohet zëri **5.9 “Shpenzime për reklama për shoqërinë në tërësi”**.
3. Në grupin II “Shpenzime të tjera operative”:
 - a) Në zërin 1 “Provizionim debitorësh të këqinj”, shtohen rreshtat, si vijon:

1	Provizionim debitorësh të këqinj (1.1+1.2)
	1.1 Për debitorë që rrjedhin nga veprimtaria direkte e sigurimit
	1.2 Për debitorë të tjerë

- b) Në zërin 2 “Shpenzime të tjera operative”, shtohen rreshtat, si vijon:

2	Shpenzime të tjera operative (2.1+2.2+2.3+2.4)
	2.1 Shpenzime për kontribute në dëmet e paguara të FK
	2.2 Ndryshimi në provizionet e dëmeve të FK (+/-)
	2.3 Shpenzime për taksën kombëtare mbi primet e shkruara
	2.4 Shpenzime për buxhetin e BSHS

Neni 2

Në aneksin 2, “Forma, përmbajtja dhe mënyra e plotësimit të raportit mbi aktivet në mbulim të provigjoneve teknike”, të nenit 4, pika 1, shkronja “b”:

1. Në pasqyrën FI 10.2, “Raport mbi Aktivet në mbulim të Provigjoneve Teknike, Pjesa 2”, pas zërit 5, shtohet një zë i ri **“6. Investime të tjera financiare”**.
2. Në pasqyrën FI 10.3, “Raport mbi Aktivet në mbulim të Provigjoneve Teknike, Pjesa 3”, zëri 10, ndryshon si vijon:

10	Llogari të arkëtueshme tregtare nga risiguruesi	
	Risigurues >= BBB-	
		<= 90 ditë
		> 90 ditë
	Risigurues < BBB-	
		<= 90 ditë
		> 90 ditë

3.Në pasqyrën FI 10.4, “Raport mbi Aktivet në mbulim të Provigjoneve Teknike, Pjesa 4”:

a) zëri 13, ndryshon si vijon:

13	Llogari të arkëtueshme tregtare që rrejdhin nga veprimtaria direkte e sigurimit	
	Policëmbajtës	<= 90 ditë
		90 ditë deri 1 vit
		> 1 vit
	Ndërmjetës	<= 90 ditë
		90 ditë deri 1 vit
		> 1 vit
	Të tjerë	<= 90 ditë
		90 ditë deri 1 vit
		> 1 vit

b) pas zërit 13, shtohet një zë i ri 14

14	Llogari të arkëtueshme tregtare që rrjedhin nga veprimtaria direkte e risigurimit	
	Nga risigurime të shitura nga shoqëria	<= 90 ditë
		> 90 ditë

4. në fund, shtohet tabela si vijon:

A	Vlera e aktiveve të lejuara në mbulim të P.T.	
B	Provizionet teknike bruto	
C	Tepricë (+)/ Mungesë (-), (A-B)	
D	Në %, (A/B%)	

Neni 3

Në aneksin 3, “Forma, përmbajtja dhe mënyra e plotësimit të raportit mbi mjaftueshmërinë e kapitalit”, të nenit 4, pika 1, shkronja “c”:

1. Në pasqyrat FI 9.1, FI 9.2, FI 9.3, FI 9.4 “Raport mbi Mjaftueshmërinë e Kapitalit, Pjesa 1, Pjesa 2, Pjesa 3, Pjesa 4”, emërtimi në kollonën “Rregullime të vlerave (sipas nenit 94, ç, iii të të ligjit të sigurimeve IA/ 96, 2. të ligjit të sigurimeve IA/ tjetër)”, zëvendësohet me emërtimin “**Elementet e zbritshëm sipas nenit 79 të Ligjit Nr. 52/2014**”.

2. Në pasqyrën FI 9.3, “Raport mbi Mjaftueshmërinë e Kapitalit, Pjesa 3”, zëri 10, ndryshon si vijon:

10	Llogari të arkëtueshme tregtare nga risiguruesi	
		<= 90 ditë
		> 90 ditë

3. Në pasqyrën FI 9.4, “Raport mbi Mjaftueshmërinë e Kapitalit, Pjesa 4”:

a) zëri 13, ndryshon si vijon:

13	Llogari të arkëtueshme tregtare që rrjedhin nga veprimtaria direkte e sigurimit	
	Policëmbajtës	<= 90 ditë
		> 90 ditë
	Ndërmjetës	<= 90 ditë
		> 90 ditë
	Të tjerë	<= 90 ditë
		> 90 ditë

b) pas zërit 13, shtohet një zë i ri 14, si vijon:

14	Llogari të arkëtueshme tregtare që rrjedhin nga veprimtaria direkte e risigurimit	
		<= 90 ditë
		> 90 ditë

c) në zërin 15 “Të tjera llogari të arkëtueshme tregtare”, emërtimi “Llogari të arkëtueshme tregtare nga fondet e garancisë (Kartoni Jeshil, Fondi i Kompensimit, etj)”, zëvendësohet me emërtimin “**Llogari të arkëtueshme tregtare për dëmet e Kartonit Jeshil dhe të Fondit të Kompensimit**”.

ç) në fund të pasqyrës, shtohet një tabelë e re, si vijon:

Llogaritja e kapitalit (Aftësisë paguese)		<i>Lekë</i>
A	Kapitali bazë dhe kapitali shtesë (Kapitalet e veta sipas pasivit të bilancit)	
B	Elementet e zbritshme në llogaritjen e kapitalit, sipas nenit 79 të Ligjit Nr. 52/2014	
C	Kapitali (Aftësia paguese): (A-B)	
D	Kufiri minimal i aftësisë paguese, sipas pikës 3 të nenit 80 të Ligjit Nr. 52/2014	
E	Fondi i garancisë, sipas nenit 81 të Ligjit Nr. 52/2014	
F	Niveli i kërkuar i aftësisë paguese, sipas pikës 2 të nenit 80 të Ligjit Nr. 52/2014	
G	Mbi (+) / nën (-) nivelin e kërkuar të Aftësisë paguese (C-F)	
H	<i>Mjaftueshmëria e kapitalit</i>	<i>I mjaftueshëm/ I pamjaftueshëm</i>

Neni 4

Bazuar në Rregulloren nr. 19, datë 28.04.2015 "Për aktivet në mbulim të provigjoneve teknike dhe llojet e investimeve të lejuara të këtyre aktiveve":

a) në pasqyrat “Raport mbi Aktivet në mbulim të Provigjoneve Teknike”, në kolonën “**Vlera e aktiveve të lejuara në mbulim të P.T.**” të pasqyrohen kufizimet në investime sipas kushteve të paraqitura në formulat e tabelave në formatin Excel bashkangjitur kësaj rregulloreje.

b) ndryshimet e mësipërme të reflektohen edhe në pasqyrat e sistemit AMF In-Reg.

Neni 5

Në pasqyrat ku janë bërë shtesa dhe ndryshime sipas kësaj rregulloreje, të bëhen **rinumërtimet** përkatëse.

Neni 6

Këto shtesa dhe ndryshime hyjnë në fuqi menjëherë.

Raportimi për vitin 2015 do të bëhet sipas pasqyrave me shtesat dhe ndryshimet e miratuara me këtë rregullore.